



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE

Kom.Dh.Shk.II.nr.77/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitij Ymeri, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Company B.... me seli në Gjilan, të cilin e përfaqëson me autorizim R.G. kundër të paditurës Komuna e Shtimes, të cilën e përfaqëson me autorizim L.M., duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.776/18 i datës 23.07.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 28.10.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET ankesa e paditësit Company B.... me seli në Gjilan, ANULOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.776/18 i datës 23.07.2020, dhe çështja i kthehet Dhomës së Shkallës së Parë-Departamenti për çështje ekonomike i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

A R S Y E T I M

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.776/18, i datës 27.10.2020, e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit Company B.... me seli në Gjilan, e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Shtimes, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t,ia kompensoj shumën e mjeteve financiare prej 100,440.79€ me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 21 maj 2008 deri në ditën e përmbushjes së obligimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit Company B.... me seli në Gjilan, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozimin që ankesa e paditësit të aprovohet si e bazuar, të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, C.nr.776/18, i datës 23.07.2020 me të cilin është refuzuar kërkesëpadia në çështjen juridike kompensim dëmi,

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Kolegji i Dhomës së Shkallës i Dytë e Gjykatës Komerciale në Prishtinë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 dhe nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi Company B... me seli në Gjilan, me datën 23.08.2018 ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë kundër të paditurit Komuna e Shtimes, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija e tij, ashtu që të detyrohet i padituri t'ia kompensoj shumën e mjeteve prej 100,440.79€ me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 21.05.2008 e deri në ditën e përmbushjes së obligimit. Ka kërkuar nga gjykata pagesën e taksave gjyqësore dhe shpenzimet tjera.

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e ankimuar C.nr.776/18 i datës 23.07.2020, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadijinë e paditësit Company B... me seli në Gjilan, e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Shtimes, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj shumën e mjeteve financiare prej 100,440.79€ me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 21 maj 2008 deri në ditën e përmbushjes së obligimit.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, sipas detyrës zyrtare ka gjetur se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2, pika (f) e që përbejnë arsye për prishjen e këtij aktvendimi. Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në atë se gjykata ka vendosur për kërkesëpadijinë për të cilën është kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë ose gjykata e llojit tjetër.

Kolegji, sipas detyrës zyrtare dhe duke i'u referuar nenit 19 të LPK-së gjeti se secila gjykatë gjatë gjithë procedurës së shkallës së parë, sipas detyrës zyrtare kujdesët për kompetencën e vet lëndore, ndërsa në rastin konkret gjeti se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me nenin 17.1 të LPK-së ku thuhet se “*Gjykata sipas detyrës zyrtare, menjëherë pas marrjes së padisë, duhet të konstatojë se a është kompetente për procedimin e çështjes që i është paraqitur*” dhe nenit 29 të LPK-së ku thuhet se “*në procedurë kontestimore gjykatat gjykojnë brenda kufijve të kompetencës së vet lëndore të caktuar me ligj*”.

Po ashtu duke u bazuar në nenin 16 paragrafi 1 nën paragrafi 1 i Ligjit për Gjykatat me Nr. 06/L – 054, ka rezultuar se paditësi nuk ka mundur të jetë palë në procedurë për këtë rast në këtë Departament të kësaj Gjykate, sepse paditësi e ka pasur statusin e shoqërisë tregtare SH.A.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë fillimisht është dashtë ta vlerësojë kompetencën e vet lëndore në këtë çështje juridike. Neni 13 pika 1, nën pika 1.1 LIGJI (NR.08/L-015) për Gjykatën Komerciale përcakton se “*kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaj, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre*”.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, sipas detyrës zyrtare gjeti se me nenin 13 par 1.1 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale është përcaktuar kompetenca lëndore e Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë dhe Dhoma e Shkallës së Dytë si vijon: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*.

Me aktgjykimin e ankimuar gjykata e shkallës së parë ka vendosur sipas kërkesës, duke mos pasur kompetencë lëndore për zgjedhjen e kësaj çështje juridike dhe në këtë rast ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 182 paragrafi 1 pika (f) me të cilën është paraparë se *“ në çoftëse gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtte, gjykata e llojit tjetër”*.

Andaj, shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë është kujdesur sipas detyrës zyrtare, e që kanë pasur apo kanë mundur të kenë ndikim në marrjen e aktgjykimin të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktgjykimi i ankimuar doemos është dashur të priset dhe të kthehet në Dhomën e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje ekonomike i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, për rishqyrtim dhe rivendosje.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (c) të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.77/22 datë 28.10.2022

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Krenar Berisha